

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E PEJËS

Për Aktivitetin e Prokurimit: Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës

LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol

LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq

LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë

LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë

LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I

LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa II

LOT 7 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa III

LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë pjesa II

LOT 9 Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës(Shtupeq i madh dhe Shtupeq i vogel)

Nr i Prokurimit	635-26-3347-5-1-1
Nr i brendshëm	635-26-033-511

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“JOOS&KRASNIQI-BAZË” SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Junik
(Adresa)

Komuna Junik
(Vendi)

51050
(Kodi postar)

+383 49 766 804
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Agron Krasniqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@jooskrasniqi.com
almedina.gervalla@jooskrasniqi.com
(Adresa elektronike)

16.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit në fjalë më datë 22.05.2026.

Pas analizimit të Dosjes së Tenderit dhe konstatimit të një sërë shkeljesh ligjore, kufizimesh të konkurrencës, specifikimesh teknike diskriminuese, si dhe gabimeve materiale dhe aritmetike në Paramasë dhe Paralogari, Operatori Ekonomik ka ushtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues më datë 10.06.2026, brenda afatit ligjor të paraparë me Ligjin për Prokurimin Publik.

Më datë 11.06.2026, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendim për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, vendim i cili i është komunikuar Operatorit Ekonomik po të njëjtën datë.

Kundër këtij vendimi, duke konsideruar se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe parimet themelore të prokurimit publik, Operatori Ekonomik ushtron këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Sipas dokumenteve të publikuara në platformën elektronike të prokurimit publik, hapja e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit është planifikuar të mbahet më datë 22.06.2026, andaj trajtimi i kësaj anekese para kësaj date është me rëndësi të veçantë për mbrojtjen efektive të të drejtave të Operatorit Ekonomik dhe për parandalimin e vazhdimit të një procedure të zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Eshte ne fazën e njoftimit per kontratë

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 - Qëllimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 - Kriteret e Dhënies së Kontratës

Neni 28 – Specifikimet teknike

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK:

Neni 19 – Specifikimet Teknike

Neni 19.4 – Ndalimi i Kufizimit të Konkurrencës përmes Specifikimeve Teknike

Neni 25.1 – Hartimi i Specifikimeve Teknike

Neni 25.4 – Ndalimi i Referencave Specifike

Neni 26.6 – Standardet e Sigurimit të Cilësisë

Neni 27.1 – Kualifikimet Arsimore dhe Profesionale

Neni 27.4 – Dëshmitë mbi Pajisjet dhe Makineritë

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

I. KRONOLOGJIA E FAKTEVE DHE ANALIZA E ANKESËS

Në përputhje me nenet 108/A dhe 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, Operatori Ekonomik **JOOS & KRASNIQI** ushtron këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e datës 10.06.2026 dhe është lënë në fuqi Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit për aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, pasi i njëjti nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm faktik dhe juridik lidhur me pretendimet e ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim. Autoriteti Kontraktues ka dështuar të shqyrtojë dhe adresojë në mënyrë konkrete pretendimet tona lidhur me specifikimet teknike kufizuese, kriteret joproporcionale të kualifikimit, gabimet materiale dhe aritmetike në Paramasë dhe Parallogari, si dhe shkeljet tjera të evidentuara në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, vendimi i kontestuar mbështetet në konstatime të përgjithshme dhe deklarative, pa ofruar analizë profesionale, teknike apo juridike për secilin pretendim ankimor, duke e bërë atë të pabazuar në fakte dhe në kundërshtim me standardet e arsyetimit të kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

Si rezultat, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik të përcaktuara në nenet 1 dhe 7 të LPP-së, përkatësisht parimin e transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, konkurrencës së lirë dhe përdorimit efikas të fondeve publike. Për këto arsye, kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar dhe të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues, duke urdhëruar ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për eliminimin e shkeljeve të konstatuara.

II. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E SHKELJEVE TË KONSTATUARA

Nga përmbajtja e Dosjes së Tenderit, kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, kriteret e kualifikimit, Paramasa dhe Parallogaria, si dhe nga vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, rezulton se procedura e prokurimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat materiale dhe procedurale të legjislacionit të prokurimit publik.

Veprimet dhe mosveprimet e Autoritetit Kontraktues kanë cenuar parimet themelore të prokurimit publik, kanë kufizuar konkurrencën efektive në treg dhe kanë krijuar kushte të pabarabarta për operatorët ekonomikë, duke rezultuar në shkeljen e dispozitave në vijim:

Neni 1 – Qëllimi

Ky nen obligon Autoritetet Kontraktuese që të sigurojnë përdorimin sa më efikas, ekonomik, transparent dhe të drejtë të fondeve publike përmes garantimit të konkurrencës së lirë dhe efektive. Vendosija e kriterëve joproporcionale, diskriminuese dhe kufizuese bie ndesh me këtë qëllim, pasi redukton numrin e operatorëve ekonomikë potencialisht të kualifikuar dhe cenon konkurrencën reale në treg.

Neni 7 – Barazia në Trajtim dhe Mosdiskriminimi

Sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues obligohet të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Vendosja e kërkesave të ndryshme për lote me natyrë të njëjtë të punimeve, kërkesa selektive për standarde ISO, profile të veçanta profesionale dhe kriteret të ndryshme teknike pa arsyetim objektiv krijon trajtim të pabarabartë dhe kufizim të konkurrencës.

Neni 27 – Dosja e Tenderit

Ky nen kërkon që Dosja e Tenderit të hartohet në mënyrë të qartë, objektive dhe pa krijuar pengesa të panevojshme për konkurrencën. Kriteret dhe specifikimet e përfshira në dosjen e tenderit nuk duhet të favorizojnë apo diskriminojnë operatorë ekonomikë të caktuar.

Neni 28 – Specifikimet Teknike

Sipas këtij neni, specifikimet teknike duhet të sigurojnë konkurrencë efektive dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Referencat ndaj teknologjive specifike, kufizimet teknike të paarsyetuara dhe kërkesat që favorizojnë pajisje apo sisteme të caktuara bien ndesh me këtë dispozitë.

Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës

Ky nen kërkon që kriteret dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti Kontraktues të jenë të qarta, objektive, të matshme dhe të verifikueshme. Kërkesat kontradiktore lidhur me makineritë e marra me qira dhe mënyrën e dëshmimit të tyre krijojnë pasiguri juridike dhe mundësojnë vlerësim subjektiv të ofertave.

Neni 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Ky nen kufizon Autoritetin Kontraktues që të kërkojë vetëm ato dëshmi dhe kriteret që janë të domosdoshme për të vlerësuar aftësinë e operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratës. Kërkesat që krijojnë barrë të panevojshme administrative ose financiare bien ndesh me këtë dispozitë.

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe Profesionale

Kërkesat për personelin profesional, përvojën, licencat dhe kapacitetet teknike duhet të jenë proporcionale me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës. Kërkesat e ndryshme dhe të paarsyetuara ndërmjet loteve, si dhe imponimi i licencave të kategorisë më të lartë për projekte të rrugëve lokale, tejkalojnë kufijtë e proporcionalitetit të përcaktuar me këtë nen.

II. DISPOZITAT E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 19 – Specifikimet Teknike

Ky nen kërkon që specifikimet teknike të hartohen në mënyrë që të sigurojnë konkurrencë efektive, trajtim të barabartë dhe qasje të papenguar të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. Specifikimet nuk duhet të krijojnë pengesa të panevojshme apo të favorizojnë teknologji, produkte ose operatorë të caktuar ekonomikë.

Neni 19.4 – Ndalimi i Kufizimit të Konkurrencës përmes Specifikimeve Teknike

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë efekt kufizimin artificial të tregut apo favorizimin e operatorëve ekonomikë, produkteve ose teknologjive të caktuara. Kërkesat lidhur me sistemet Variocontrol, GPS, Laser, kufizimet e peshës së makinerive dhe specifikimet e tjera teknike të paarsyetuara cenojnë drejtpërdrejt këtë dispozitë.

Neni 25.1 – Hartimi i Specifikimeve Teknike

Autoriteti Kontraktues obligohet që specifikimet teknike t'i hartojë në mënyrë objektive dhe proporcionale, pa krijuar pengesa të pajustificueshme për konkurrencën. Kërkesat e vendosura në Aneksin 7 nuk përmbushin këtë standard ligjor.

Neni 25.4 – Ndalimi i Referencave Specifike

Kjo dispozitë ndalon referimin në marka tregtare, patenta, teknologji ose produkte specifike, përveç rasteve kur përdoret shprehja “ose ekuivalente”. Referencat ndaj sistemit Variocontrol dhe teknologjive të tjera specifike pa përdorimin e këtij formulimi bien ndesh me këtë nen.

Neni 26.6 – Standardet e Sigurimit të Cilësisë

Kur kërkohen certifikata ISO, ato duhet të jenë të lidhura me objektin e kontratës, të njohura ndërkombëtarisht dhe të kërkuara në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë. Kërkesat e ndryshme për standardet ISO, si dhe referimet ndaj standardeve të pasakta ose jo valide, bien ndesh me këtë dispozitë.

Neni 27.1 – Kualifikimet Arsimore dhe Profesionale

Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit të kërkuar duhet të jenë drejtpërdrejt të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën e saj. Kërkesa për profile profesionale që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me asfaltimin dhe ndërtimin e rrugëve lokale, si dhe kërkesat e tepruara për licenca dhe përvojë profesionale, bien ndesh me këtë dispozitë.

Neni 27.4 – Dëshmitë mbi Pajisjet dhe Makineritë

Kjo dispozitë lejon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e pajisjeve përmes pronësisë, marrëveshjeve të qirasë ose marrëveshjeve të tjera ligjore. Kërkesat që makineritë e marra me qira të jenë të regjistruara në emër të operatorit ekonomik ofertues ose kërkesat e paqarta lidhur me dokumentacionin e tyre tejkalojnë kërkesat e parapara me këtë dispozitë.

Për rrjedhojë, kriteret e kontestuara në Dosjen e Tenderit janë në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe transparencës, të garantuara nga Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Përveç dispozitave të sipërcituara, Autoriteti Kontraktues ka dështuar të zbatojë edhe parimet themelore të proporcionalitetit, transparencës, konkurrencës së lirë dhe përdorimit efikas të fondeve publike, të cilat përbëjnë bazën e sistemit të prokurimit publik në

Republikën e Kosovës. Këto shkelje janë shtjelluar në mënyrë të detajuar në pretendimet ankimore të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe në këtë ankesë, duke dëshmuar se Dosja e Tenderit përmban kërkesa kufizuese, kritere joproporcionale dhe mangësi të tjera që cenojnë drejtpërdrejt konkurrencën e drejtë dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

II. KUNDËRSHTIMI JURIDIK I VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES DHE SHKELJET THELBËSORE PROCEDURALE

Si Operator Ekonomik, kundërshtojmë në tërësi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 11.06.2026 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, për shkak se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat imperative të legjislacionit në fuqi dhe, për pasojë, nuk mund të prodhojë efekte juridike të ligjshme.

1. Shkelja e Nenit 108/A të LPP-- Mungesa e Vendimit të Arsytuar

Neni 108/A i Ligjit për Prokurimin Publik pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, të shqyrtojë secilin pretendim të ngritur dhe të nxjerrë vendim të arsyetuar, duke paraqitur analizën faktike dhe juridike mbi të cilën mbështetet vendimmarrja e tij.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka dështuar plotësisht ta përmbushë këtë detyrim ligjor. Vendimi i datës 11.06.2026 nuk përmban asnjë analizë konkrete të pretendimeve të ngritura, por kufizohet në konstatime të përgjithshme dhe shabllone, duke i cilësuar pretendimet tona si “subjektive”, pa shpjeguar se përse specifikimet teknike të kontestuara, kriteret kufizuese apo gabimet e evidentuara në paramasa konsiderohen të ligjshme.

Autoriteti Kontraktues nuk ka trajtuar në mënyrë individuale asnjërin nga pretendimet e paraqitura, duke shmangur detyrimin ligjor për të dhënë arsyetim substancial. Një vendim i tillë nuk e përmbush standardin e kërkuar nga neni 108/A i LPP-së prandaj është juridikisht i cenueshëm dhe i anulueshëm.

2. Shkelja e Neneve 48 dhe 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative – Mungesa e Arsytimit të Aktit Administrativ

Edhe pse procedura e prokurimit publik rregullohet nga Ligji për Prokurimin Publik si ligj special, nxjerrja dhe vlefshmëria e akteve administrative i nënshtrohet edhe parimeve dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Sipas nenit 48 të LPA-së, çdo akt administrativ me shkrim duhet të përmbajë:

1. paraqitjen e kërkesës së palës;
2. faktet e vërtetuara gjatë procedurës;
3. bazën ligjore mbi të cilën mbështetet vendimi; dhe
4. arsyetimin që shpjegon pse është vendosur në atë mënyrë.

Ndërkaq, neni 52 i LPA-së parasheh se akti administrativ që nuk përmban arsyetim adekuat ose ka mangësi thelbësore në arsyetim konsiderohet i paligjshëm.

Në rastin konkret, vendimi i kontestuar nuk përmban analizë të fakteve, nuk identifikon dispozitat ligjore të aplikuara për secilin pretendim dhe nuk ofron asnjë arsyetim se përse

pretendimet tona janë refuzuar. Përdorimi i formulimeve të përgjithshme dhe deklarative nuk mund të konsiderohet arsyetim në kuptim të LPA-së.

Për pasojë, vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë në kundërshtim me kërkesat minimale ligjore për vlefshmërinë e një akti administrativ dhe si i tillë duhet të anulohet.

3. Shkelja e Parimit të Transparencës dhe Trajtimit të Barabartë sipas Neneve 1 dhe 7 të LPP-së

Neni 1 i LPP-së përcakton se prokurimi publik duhet të zhvillohet në mënyrë transparente, efikase dhe me përdorim racional të fondeve publike, ndërsa neni 7 garanton trajtim të barabartë dhe mosdiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë.

Duke refuzuar kërkesën për rishqyrtim përmes një vendimi të paarsyetuar dhe pa adresuar shqetësimet konkrete lidhur me specifikimet teknike kufizuese, Autoriteti Kontraktues ka cenuar rëndë këto parime themelore.

Veçanërisht, AK nuk ka dhënë asnjë sqarim lidhur me kërkesat teknike që referojnë karakteristika specifike të prodhuesve të caktuar, përfshirë sistemet e kontrollit dhe parametrat teknikë që kufizojnë konkurrencën efektive në treg. Mungesa e arsytimit dhe refuzimi për të adresuar këto pretendime krijon dyshime serioze mbi respektimin e parimit të transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

4. Mosadresimi i Gabimeve Materiale dhe Aritmetike në Paramasa –

Në Kërkesën për Rishqyrtim janë identifikuar dhe argumentuar në mënyrë të detajuar gabime materiale, aritmetike dhe mungesa të pozicioneve në Paramasat dhe Paralogaritë e Loteve 1, 6 dhe 8.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje, analizë apo sqarim lidhur me këto pretendime, duke i kaluar ato plotësisht në heshtje.

Sipas LPP-së dhe parimeve themelore të prokurimit publik, dosja e tenderit duhet të hartohet në mënyrë të qartë, të saktë dhe të mjaftueshme për t'u mundësuar operatorëve ekonomikë përgatitjen e ofertave të krahasueshme dhe konkurruese.

Mbajtja në fuqi e paramasave që përmbajnë gabime materiale dhe refuzimi për të shqyrtuar pretendimet e ngritura lidhur me to cenon drejtpërdrejt parimin e konkurrencës së ndershme, barazisë së operatorëve ekonomikë dhe transparencës së procedurës së prokurimit, duke e bërë procedurën të cenueshme dhe të paligjshme.

Pavarësisht shkeljeve të rënda procedurale të evidentuara më sipër, të cilat në vetvete paraqesin bazë të mjaftueshme ligjore për anulimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues, Operatori Ekonomik mbetet në tërësi pranë pretendimeve ankimore të paraqitura fillimisht në Kërkesën për Rishqyrtim.

Për shkak se Autoriteti Kontraktues nuk ka shqyrtuar dhe as nuk ka adresuar në mënyrë konkrete këto pretendime, me qëllim të mbrojtjes efektive të të drejtave tona dhe sigurimit të një shqyrtimi të plotë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, më poshtë paraqesim në mënyrë

të detajuar shkeljet materiale dhe ligjore që karakterizojnë Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Në vijim paraqiten pretendimet ankimore, të cilat dëshmojnë se kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues janë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe me parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

Pretendimi 1: Diskriminim dhe joproporcionalitet i kriterëve ISO (Neni 7 i LPP)

Nga analizimi i kriterëve të vendosura në kapitullin e *Përshatshmërisë Profesionale* lidhur me certifikimet e cilësisë (ISO), evidentohet një qasje tërësisht joprofesionale dhe diskriminuese nga ana e Autoritetit Kontraktues. Për punë me natyrë krejtësisht të njëjtë (asfaltim rrugësh), AK ka hartuar kërkesat e standardeve ISO me mospërputhje të theksuara teknike, gabime në vite të versioneve të standardeve, si dhe trajtim të pabarabartë sa i përket formës së dëshmimit të tyre.

Mospërputhjet dhe dallimet e pastra arbitrare midis loteve specifikohen si në vijim:

1. Pasqyra Krahasuese e Anomalive të Standardeve ISO sipas Loteve

- **Mospërputhja te standardi ISO 45001 (Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë):**
 - **LOT 1:** AK kërkon versionin **ISO 45001:2015**.
 - **LOT 2 dhe LOT 5:** AK kërkon versionin **ISO 45001:2018**.
 - *Absurdi Juridik/Teknik:* Standardi ndërkombëtar ISO 45001 për herë të parë është publikuar në vitin **2018** (duke zëvendësuar standardin e vjetër OHSAS 18001). Versioni "ISO 45001:2015" nuk ekziston fare në fushën e standardizimit ndërkombëtar. Kjo dëshmon se AK ka shpikur standarde joekzistente për LOT 1, duke krijuar paqartësi totale dhe mundësi eliminimi arbitrar.
- **Luhatja dhe kontradikta te emërtimi i ISO 39001:2012 (Menaxhimi i Sigurisë së Trafikut Rrugor):**
 - **LOT 1:** Ky standard kërkohet me emërtimin: *"...per permirsimin ne siguris në punë"*.
 - **LOT 2 dhe LOT 5:** Po i njëjti standard kërkohet me emërtimin e saktë: *"...Sistemi I Menagjimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor"*.
 - *Absurdi Juridik/Teknik:* Përveç që përbën gabim të rëndë profesional, ky emërtim i ndryshëm për të njëjtin standard brenda të njëjtit tender krijon konfuzion dhe paqartësi juridike në dëm të OE-ve, në kundërshtim me Nenin 60 të LPP-së.
- **Trajtimi i pabarabartë dhe diskriminues në formën e dëshmimit (Kopje vs. Noterizim):**
 - **LOT 1:** Mjafton dorëzimi i certifikatave ISO në formë të **kopjes së thjeshtë** (*Dëshmia 3: "Certifikatat ISO per te njejten natyre si projekti (kopje)"*).
 - **LOT 2 dhe LOT 5:** Kushtëzohet në mënyrë rigoroze që certifikatat ISO të jenë të **noterizuara** (*Dëshmia 3: "...me CERTIFIKATË ISO valide- të noterizuara"*).
 - *Absurdi Juridik/Teknik:* Ky është një diskriminim i hapur dhe flagrant. Pse për të njëjtin aktivitet prokurimi dhe për të njëjtat certifikata, një OE që aplikon në LOT 1 lejohet t'i dorëzojë ato si kopje e thjeshtë, ndërsa një OE

që aplikon në LOT 2 apo LOT 5 eliminohet nëse nuk i ka të noterizuara? Ky dallim nuk ka asnjë bazë ligjore dhe shkel direkt Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim).

Duke kërkuar një standard që nuk ekziston në tregun ndërkombëtar (ISO 45001:2015 për Lotin 1), Autoriteti Kontraktues ka hartuar një dosje konfuze. Operatorët Ekonomikë e kanë të pamundur të ofrojnë një dokument që nuk ekziston, gjë që çon automatikisht në eliminim të paligjshëm apo në vlerësim subjektiv nga komisioni.

Imponimi i detyrimit për noterizim të certifikatave vetëm për disa lote të caktuara (Lot 2 dhe Lot 5) dhe lejimi i kopjeve të thjeshta për lotet e tjera, paraqet aplikim të dyfishtë të standardeve të vlerësimit për të njëjtën kategori dokumentesh.

Kopjimi i gabuar i termave dhe versioneve të ISO-ve tregon se këto kritere janë vendosur mekanikisht, pa asnjë analizë të mirëfilltë ligjore e teknike, me qëllim të vetëm krijimin e barrierave artificiale.

Emërtimet kontradiktore të të njëjtit standard dhe kushtëzimi selektiv me certifikata të noterizuara vetëm për lote të caktuara, e bëjnë këtë procedurë të prokurimit plotësisht të cenueshme. Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë harmonizimin e menjëhershëm të këtyre kërkesave, të fshijë versionet joekzistente të standardeve dhe të mundësojë që dëshmitë (kopjet) të jenë unike dhe të barabarta për të gjitha lotet, pa ngarkesa të paligjshme financiare e administrative për noterizime selektive.

Pretendimi 2: Kritere të paarsyeshme dhe kufizuese për stafin profesional

Nga analizimi i hollësishëm i kritereve të vendosura për stafin profesional në të 9 lotet e këtij aktiviteti të prokurimit, evidentohet një pabarazi e paprecedentë dhe trajtim tërësisht arbitrar i Operatorëve Ekonomikë. Autoriteti Kontraktues (AK) ka hartuar kërkesa dhe dëshmi në kundërshtim të rrept me LPP, pa asnjë logjikë inxhinierike apo arsyetim objektiv teknik, duke shkelur rëndë parimin e proporcionalitetit dhe të konkurrencës së lirë.

Për të dëshmuar këtë mospërputhje skandaloze, më poshtë paraqesim pasqyrën krahasuese të kritereve të kërkuara sipas loteve për të njëjtën natyrë pune (asfaltim dhe ndërtim rrugësh lokale):

1. Pasqyra Krahasuese e Kushteve të Stafit midis Loteve

- **Menaxheri i Projektit (Inxhinieri i Ndërtimtarisë):**
 - **LOT 1:** Kërkohet Master (Drejtimi Konstruktiv), me **5 vite** përvojë pune dhe i pajisur me **Licencë A**.
 - **LOT 2:** Mjafton Bachelor me **5 vite** OSE Inxhinier i Diplomuar (4-vjeçar) me vetëm **3 vite** përvojë pune (nuk kërkohet licencë specifike).
 - **LOT 3:** Kërkohet Inxhinier i Diplomuar ose Master (Konstruktiv) me **6 vite** përvojë pune, por në mënyrë absurde kjo përvojë kërkohet *pas certifikimit* (jo pas diplomimit).
 - **LOT 4:** Kërkohet Master ose Inxhinier i Diplomuar (Infrastrukturë rrugore ose Konstruktiv) me **5 vite** përvojë pune.
 - **LOT 5:** Kërkohet Master ose Inxhinier i Diplomuar (Konstruktiv ose Infrastrukturë) me **5 vite** përvojë pune PLUS kushtëzimi që të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë.

- **LOT 6 & 7:** Kërkohe Inxhinier i Diplomuar ose Master (Konstruktiv) me **5 vite** përvojë pune.
- **LOT 8:** Mjafton niveli Bachelor me vetëm **3 vite** përvojë pune.
- **LOT 9:** Kërkohe Master ose Inxhinier i Diplomuar (Konstruktiv) me madje **8 vite** përvojë pune, i pajisur me **Licencë të Kategorisë "A"** (sipas Ligjit nr. 08/L-012) dhe i certifikuar si menaxher punishteje për shëndet dhe siguri.
- **Gjeodeti (Inxhinieri i Gjeodezisë):**
 - **LOT 1:** Kërkohe thjesht "Gjeodeti i licencuar" me **5 vite** përvojë pune.
 - **LOT 2:** Kërkohe gradë Master me **3 vite** përvojë pune.
 - **LOT 3:** Kërkohe ekskluzivisht gradë Master me **5 vite** përvojë pune.
 - **LOT 5:** Kërkohe Inxhinier i Diplomuar ose Master me një kriter të stërmadh prej madje **8 vite** përvojë pune pas diplomimit.
 - **LOT 6 & 7:** Mjafton niveli Bachelor me **5 vite** përvojë pune dhe i licencuar.
 - **LOT 8:** Mjafton niveli Bachelor me vetëm **3 vite** përvojë pune (pa asnjë kërkesë për licencë).
 - **LOT 9:** Lejohet Inxhinier i Diplomuar/Master me **3 vite** ose Bachelor me **5 vite** përvojë pune.

Mbi bazën e këtij krahasimi, asimetria e kriterëve dëshmon pesë gjetje kyçe të cilat e bëjnë këtë Dosje Tenderi të paligjshme:

- **Gjetja I: Diferencim arbitrar, i pashpjegueshëm dhe i çrregullt i përvojës (Shkelje e Nenit 7 dhe 69 të LPP):** Është juridikisht dhe teknikisht e pamundur të arsyetohet se pse për të njëjtin profil të punëve (asfaltim rrugësh brenda të njëjtës komunë), përvoja e kërkuar për të njëjtën pozitë (Menaxher) lëviz në mënyrë kaotike nga **3 vite** (Lot 2, Lot 8), në **5 vite** (Lot 1, 4, 5, 6, 7), në **6 vite** (Lot 3), e deri në **8 vite** (Lot 9). Ky çrregullim tregon qartë se kriteret nuk janë vendosur mbi bazën e kompleksitetit real të punës, por janë përshtatur artificialisht për t'iu përshtatur "CV-ve" të caktuara, duke eliminuar në mënyrë diskriminuese Operatorët e tjerë Ekonomikë.
- **Gjetja II: Paradoksi i Gradave Akademike (Bachelor vs. Master):** Në LOT 3 dhe LOT 5, për pozicionin e Gjeodetit kërkohe në mënyrë strikte grada Master (madje në Lot 5 me 8 vite përvojë), ndërsa në lotet e tjera si LOT 6, LOT 7 dhe LOT 8 mjafton niveli Bachelor me 3 apo 5 vite përvojë. Nuk ekziston asnjë specifikë topografike apo gjeodezike që arsyeton pse një gjeodet me Bachelor mund të kryejë punët në Lotin 6, ndërsa po në të njëjtin qytet për Lotin 5 na kërkohe titulli Master me 8 vite përvojë. Kjo kërkesë kapërcen parimin e proporcionalitetit të sanksionuar në Nenin 69 të LPP-së.
- **Gjetja III: Monopolizimi i aktivitetit përmes Licencave të Kategorisë "A" (Ligji Nr. 08/L-012):** Në LOT 9, AK ka vendosur një barrierë eliminuese të pakalueshme duke kërkuar që **tre profili të ndryshëm të stafit** (Menaxheri i Projektit, Inxhinieri i Punishtes dhe Inxhinieri i Komunikacionit) të posedojnë që të gjithë **Licencën e Kategorisë "A"** konform Ligjit nr. 08/L-012. Licenca e Kategorisë "A" përfaqëson nivelin më të lartë të licencimit në Republikën e Kosovës (për projekte të Kategorisë së Parë të rrezikshmërisë, si autostrada apo ura të mëdha). Imponimi i njëkohshëm i tri licencave të tilla për rrugë të rëndomta lokale është një mjet i pastër që cenon Nenin 7 të LPP-së, duke dizajnuar garën vetëm për një numër jashtëzakonisht të kufizuar kompanish të mëdha.
- **Gjetja IV: Përfshirja e profileve jashtë objektit të kontratës (LOT 8):** Për LOT 8 (Kërkesa 2.4), AK ka kërkuar pozicionin "*Master i Shkencave në Xehetari, i specializuar për shpim-plasje*". Kërkesa për një inxhinier minierash (xehetarie) në

një tender që ka për objekt ekskluziv asfaltimin e rrugëve, është krejtësisht e palogjikshme dhe në kundërshtim të hapur me Nenin 27.1 të Rregullores, i cili kërkon lidhshmëri të drejtpërdrejtë të kualifikimit me objektin e kontratës.

- **Gjetja V: Kërkesa absurde dhe pengesa administrative në dëshmi (LOT 5):** Tek dëshmitë për LOT 5 (Dëshmia 2, 2.1 dhe 2.2), AK kërkon që kontratat e punës të jenë *"kopje e noterizuar në prezencë të punëdhënësit dhe punëmarrësit"*. Kjo kërkesë bie ndesh me praktikën e prokurimit dhe me Nenin 27.5 të Rregullores. LPP lejon dorëzimin e parakontratave apo marrëveshjeve të nënshkruara mes palëve si dëshmi angazhimi për projektin. Detyrimi që inxhinierët të shkojnë fizikisht te noteri së bashku me përfaqësuesin e OE-së vetëm për fazën e ofertimit përbën një barrë të paligjshme administrative, e cila çuditërisht nuk kërkohet në asnjë lot tjetër të këtij tenderi.

Ky diferencim ekstrem dhe i paarsyeshëm i kritereve për stafin teknik nëpër lote të ndryshme për punë me natyrë tërësisht të njëjtë vërteton se Dosja e Tenderit është hartuar në mënyrë selektive, preferenciale dhe me qëllim të kufizimit të qasjes në treg. Rrjedhimisht, kërkohet nga Autoriteti Kontraktues që të anulohet këto kritere eliminuese dhe t'i harmonizojë ato në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë sipas LPP-së.

Pretendimi 3: Kërkesa të tepërta për certifikimin e punëtorëve

Për LOT 5, AK kërkon që nga minimumi 20 punëtorë, të paktën 15 prej tyre të jenë të certifikuar për siguri në punë dhe të kenë sigurim shëndetësor përpara datës së publikimit të kontratës. Po ashtu, për LOT 3 kërkohen 10 punëtorë të trajnuar dhe për LOT 9 kërkohen 20 punëtorë të trajnuar nga kompani të licencuara nga MPMS. Trajnimi i stafit mbështetës/punëtorëve fizikë në këtë nivel masiv përpara nënshkrimit të kontratës është një barrë financiare e paligjshme për OE-të që aplikojnë, pasi këto certifikime mund të kërkohen si kusht për ekzekutim të kontratës, por jo si kriter kualifikues në fazën e ofertimit.

Pretendimi 4: Kërkesë e paligjshme e sigurimit shëndetësor para kontratës

Në **LOT 5 (Kërkesa 3 dhe Dëshmia 3)**, Autoriteti Kontraktues (AK) ka vendosur një kriter skandaloz dhe të paprecedentë në praktikën e prokurimit publik, duke kërkuar që:

- *"...minimum 15 punëtorë duhet të jenë të certifikuar për siguri në punë dhe të kenë sigurim shëndetësor nga një kompani e sigurimeve para datës së publikimit të kontratës... Të dëshmohet me faturë / policë të sigurimit me numër të kontratës"*.

Ky kriter përbën shkelje flagrante të parimeve të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 për shkak të këtyre argumenteve juridike të pakontestueshme:

AK detyron Operatorët Ekonomikë (OE) që të bëjnë shpenzime të jashtëzakonshme e të parakohshme luksi financiare (blerjen e policave të sigurimit shëndetësor privat për 15 punëtorë) për një projekt që ende nuk e kanë fituar dhe nuk dihet nëse do ta fitojnë. Kjo kërkesë dëmton rëndë likuiditetin e kompanive të mesme dhe favorizon vetëm oligopolet që kanë kapacitete financiare për të bllokuar mjete në polica sigurimi "në rrezik".

Kërkesat e natyrës sociale, të sigurisë në punë apo të sigurimeve të stafit, mund të jenë **ekskluzivisht kushte për zbatimin e kontratës** (pasi OE të shpallet fitues dhe para

nënshkrimet/fillimit të punëve) dhe asnjëherë kritere kualifikuese/eliminuese në fazën e dorëzimit të ofertës.

Asimetri dhe trajtim selektive midis loteve: Ky kushtëzim vlen vetëm për LOT 5. Në lotet e tjera me natyrë identike të punës (si LOT 3, LOT 4, LOT 6, LOT 7, LOT 9), ku po ashtu kërkohet numër i madh punëtorësh (10 deri në 20 punëtorë), AK-ja *nuk ka kërkuar* polica të sigurimit shëndetësor para tenderimit e as faturë dëshmuese. Pse rrezikshmëria e punës në LOT 5 qenka më e lartë se në lotet e tjera kur objekti i kontratës është i njëjtë (asfaltim)? Kjo vërtetohet se kriteri është vendosur me tendencë të pastër eliminimi.

Pretendimi 5: Kontradiktë dhe paqartësi në dëshmitë e mjeteve/makinerisë

Tek **Kërkesa 8 dhe Dëshmia 8** (e aplikueshme për të gjitha lotet nga 1 deri në 9), Autoriteti Kontraktues ka hartuar një tekst tërësisht kontradiktor, i cili privon Dosjen e Tenderit nga çdo objektivitet dhe hap rrugë për eliminime masive e te paligjshme.

Në të njëjtin paragraf, AK specifikon:

1. *Nga njëra anë:* Lejon që pajisjet dhe makineria të mos jenë në pronësi të OE, por të kontraktuara apo me qira (“...që OE duhet t'i ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira)”).
2. *Nga ana tjetër:* Kushtëzon në mënyrë absolute regjistrimin dhe sigurimin në emër të ofertuesit që në fazën e tenderimit, duke sanksionuar me eliminim: “*Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid... O.E të cilët nuk i kanë pajisjet e regjistruara eliminohen nga ky A.P.*”.

Ky formulim krijon një absurditet të pastër juridik dhe teknik:

- **Pamundësia juridike e zbatimit të kriterit:** Nëse një Operator Ekonomik legjitimohet nga LPP-ja dhe nga vetë Dosja e Tenderit që pajisjet (p.sh. ekskavatorë, rula, kamionë) t'i marrë **me qira** apo përmes **marrëveshjes së qirasë/furnizimit** vetëm nëse shpallet fitues i kontratës, është juridikisht dhe logjikisht e pamundur që ai OE të posedojë librezë regjistrimi apo polica të sigurimit valid të automjeteve **në emër të tij** në momentin e dorëzimit të ofertës. Regjistrimi dhe sigurimi i takojnë pronarit (qiradhënësit), jo qiramarrësit në fazën e ofertimit!
- **Aplikimi i standardit të dyfishtë për Noterizimin (LOT 2, 8, 9 vs. Lotet e tjera):** Për më tepër, te **Dëshmia 7 dhe 8 (për LOT 2, LOT 8 dhe LOT 9)**, AK kërkon në mënyrë të prerë që: “*Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit*”. Ndërsa për të gjitha lotet e tjera, kjo marrëveshje qiraje pranohet si marrëveshje e thjeshtë dypalëshe. Nuk ka asnjë bazë ligjore në LPP që i jep të drejtë AK-së të kërkojë noterizim në prezencë të noterit për marrëveshjet e makinerisë vetëm për tri lote, duke e lënë të lirë për lotet e tjera.
- Ky formulim konfuz, ku lejimi i qirasë përplasat me detyrimin e regjistrimit dhe ku kushtet e noterizimit fluktojnë sipas loteve, cenon parimin e specifikimeve të qarta dhe objektive. Ky draftim joprofesional i DT-së i jep Komisionit të Vlerësimit autoritet diskrecional që të eliminojë cilindo OE që dëshiron me pretekstin e “mungesës së regjistrimit të pajisjeve me qira”, duke shkelur hapur parimin e transparencës dhe sigurisë juridike.

PRETENDIMI 6: DISKRIMINIM TEKNIK, ASIMETRI RADIKALE NË SPECIFIKIME DHE CILLËSIM I MAKINERISË TEK ANKES 7

Gjatë analizimit të **Aneksit 7 (Lista e Pajisjeve)** për të gjitha lotet, vrehet një mungesë totale e objektivitetit dhe standardizimit nga ana e Autoritetit Kontraktues. Për projekte të natyrës së njëjtë (asfaltim dhe infrastrukturë rrugore), AK ka aplikuar kritere të dyfishta, duke vendosur në disa lote specifika jashtëzakonisht kufizuese (kapacitete absurde dhe sisteme specifike teknologjike), ndërsa në lotet e tjera ka lënë kërkesa standarde.

Kjo asimetri vërteton se specifikimet nuk janë përshtatur për nevojat e projektit, por janë dizajnuar si "**kriter porosi**" për të përshtatur makineritë e një Operatori Ekonomik të caktuar dhe për të eliminuar të tjerët.

1. Absurditeti dhe Kufizimi me "Pesha Maksimale" (Kriter Eliminues pa Logjikë Inxhinierike)

Në praktikën e prokurimit dhe inxhinierisë, kapaciteti teknik i një makinerie kërkohet gjithmonë si "**minimum**" (p.sh. min. 15 ton) për të siguruar që pajisja ka fuqi të mjaftueshme për të kryer punën. AK, në mënyrë të paprecedentë, në disa lote ka vendosur "**peshë maksimale**" (**max**), gjë që do të thotë se nëse një OE ka makineri më të re, më të fuqishme dhe me kapacitet më të lartë, ai **eliminohet!**

- **Te LOT 5 (Pika 3 & 10):** Kërkohet *Dumper me peshë max 3 ton dhe Grejder me peshë max 9 ton.*
- **Te LOT 7 (Pika 1 & 3 & 4):** Kërkohet *Eskavator skip max 8.2 ton, Mini Autobetoniere max 7 ton, dhe Valak max 1.4 ton.*
- **Te LOT 9 (Pika 5 & 19):** Kërkohet *Cilindër max 2.5 ton dhe Cilindër për kanal max 1.5 ton.*

Ky kufizim me "kapacitet maksimal" shkel ne menyre flagrante **LPP-në**, i cili ndalon specifikimet që krijojnë pengesa për konkurrencën e hapur. Nuk ka asnjë arsye teknike apo inxhinierike pse një grejder 12 tonësh nuk mund ta bëjë punën e një grejderi "max 9 ton". Ky është një specifikim i pastër përjashtues.

2. Kushtëzimi me Pajisje Specifike dhe "Sisteme Ekskluzive" (Variocontrol, Laser, GPS, Kamera 360°)

AK ka specifikuar brendësi dhe teknologji të veçanta që gjenden vetëm te marka të caktuara të makinerive, duke shkelur **LPP-në** (i cili ndalon referencat në marka, patentë apo lloje të veçanta nëse nuk shoqërohen me "ose ekuivalente"):

- **Te LOT 5 (Pika 9):** Kërkohet *Cilindër min 17t vibrues ta ketë të instaluar edhe sistemin e matjes së ngjeshshmërisë (variocontrol). Sistemi "Variocontrol" është patentë e mbrojtur teknologjike e prodhuesit të njohur BOMAG. Ky emërtim i pastër teknik përjashton çdo cilindër tjetër (Caterpillar, Hamm, Dynapac) që përdor emërtime të tjera për sistemet e matjes.*
- **Te LOT 4 (Pikat 2, 4, 5, 6, 7):** Kërkohet *Buldozer me kontroll gjeodezik GPS, Eskavator me sistem kontrolli të lugës 360 shkallë dhe krah llaserik, Makinë gërryese me sistem kontrolli llaserik dhe kamera përcjellëse, Makinë finisher me GPS dhe laser.*

- Pse ky standard nuk vlen për lotet e tjera? Në LOT 2, LOT 3, LOT 6, dhe LOT 9 kërkohen po ashtu makina gërryese (freza), finisherë dhe eskavatorë për të njëjtat punë asfaltimi, por aty NUK kërkohen sisteme GPS, krahë llaserikë apo kamera 360 shkallë. Ky diferencim arbitrar dëshmon se te LOT 4 kriteret janë ngritur qëllimisht për të eliminuar konkurrencën.

3. Mosstandardizimi i kapaciteteve për të njëjtën makineri midis loteve

Dallimet në tonazhe për të njëjtën punë rrugore tregojnë se AK nuk ka pasur asnjë kriter objektiv gjatë hartimit të dosjes:

- **Eskavatorët:** Te LOT 1, kërkohet *Eskavator me zingjir min. 62 ton* (një megamakineri minierash, tërësisht e pajustificueshme për punë rrugore standarde). Te LOT 6 kërkohet *min. 39 ton*, te LOT 4 *mbi 37 ton*, te LOT 9 *min. 35 ton*, ndërsa te LOT 2 mjafton *min. 20 ton*.
- **Kamionët e Asfaltit (Kiperët):** Te LOT 2 (Pika 21) kërkohen *5 Kamionë kiper me peshë min. 32t*. Ndërsa te LOT 5 (Pika 18), ku po ashtu shtrohet asfalt, kërkohen *8 Kamionë kiper me peshë min. 15t*. Pse asfalti i LOT 2 nuk u transportuaka me kamionë 15 tonësh?

4. Kërkesa për dëshmi të performancës në listë pajisjesh

Në fund të Aneksit 7, për të gjitha lotet thuhet: "*Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe t'i bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë*".

Çfarë nënkupton AK me "dokument që evidenton performimin e tillë" për një makineri me qira? Sipas LPP-së, pajisjet dëshmohen vetëm me dëshmi pronësie (libreza/fatura) ose marrëveshje qiraje. Kërkesa për "certifikata performimi" të makinerive krijon paqartësi totale dhe i jep komisionit hapësirë për vlerësim subjektiv dhe te anshem (shkelje e **Nenit 52 të LPP-së**).

PRETENDIMI ANKIMOR 7: Shkelje thelbësore të Ligjit për Prokurimin Publik përmes hartimit të paramasave të pasakta, me gabime materiale, aritmetike dhe pozicione të paanalizuara mirë;

Gjatë shqyrtimit analitik dhe teknik të Dosjes së Tenderit (DT) për këtë aktivitet të prokurimit, është konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka hartuar një paramasë dhe paraqitje të pozicioneve me gabime të rënda materiale, kalkulime të pasakta aritmetike dhe mungesë të llogaritjes së totaleve. Këto parregullsi, të cilat prekin disa lote, manifestohen në mënyrë specifike si në vijim:

- **Pika 1. Gabimet dhe mospërputhjet në rekapitulim për LOT 1 ("Poqestë – Doberdol"):** Në kuadër të këtij loti është evidentuar një shpërputhje e rëndë në kalkulimin e vlerave totale të punëve, posaçërisht në pjesën e rekapitulimit:
 - *Rekapitulimi te Punët Tokësore:* Ka gabime të qarta në bartjen dhe llogaritjen e vlerave të përgjithshme për këtë kategori.
 - *Aneksi 1 dhe 2 të Punëve Tokësore:* Këto anekse paraqesin shpërputhje të hapura matematiko-teknike me pjesën tjetër të paramasës.
 - *Rekapitulimi Total:* Është identifikuar gabim direkt dhe i pastër në llogaritjen e vlerës për pozicionin "*Ndërtimi i murit mbrojtës*".

- **Pika 2. Gabimet në llogaritjen e totaleve specifike për LOT 6 (“Rikonstruksioni i rrugëve të qytetit”):** Në Pozicionin 4, që ka të bëjë me “*Punët e betonit dhe asfalt*”, është evidentuar një gabim material që ndikon direkt në vlerën finale të ofertës. Gabimi qëndron në mosllogaritjen apo kalkulimin plotësisht të gabuar të totalit për nën-pozicionet 4.1 dhe 4.2.
- **Pika 3. Gabimet teknike dhe procedurale për LOT 7 (“Ndërtimi dhe rregullimi i trotuarit nga rrethi i Soliterit deri te rrethi i Stacionit”):** Konkretisht në Pozicionin 6.1. “*Testimet e ngjeshmërisë*”, është identifikuar një parregullsi e qartë teknike dhe procedurale, e cila ndikon drejtpërdrejt në strukturën e çmimit dhe në pamundësinë e ofertimit të barabartë.
- **Pika 4. Eliminimi i nën-pozicionit nga kalkulimi total për LOT 8 (“Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Seinovë”):** Në Pozicionin 3 (“*Konstruksioni i hapësirës*”), është lëshuar një gabim thelbësor matematikor ku nën-pozicioni **Pos. 3.7. NUK është llogaritur fare** në vlerën totale të këtij loti, duke e lënë paramasën të mangët.

Të gjitha paqartësitë, eliminimet e pozicioneve (si në LOT 8), gabimet në totale (si në LOT 6) dhe mospërputhjet në rekapitulime (si në LOT 1) bien në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet bazë të prokurimit publik në Kosovë.

Përfundim

Nga të gjitha faktet, provat dhe argumentet juridike të paraqitura në këtë ankesë rezultojnë qartë se Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për Kontratë nuk janë hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Pretendimet ankimore të paraqitura dëshmojnë se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kritere kualifikimi, specifitime teknike dhe kërkesa administrative të cilat jo vetëm që nuk janë të lidhura në mënyrë proporcionale me objektin e kontratës, por në shumë raste paraqesin kufizime artificiale të konkurrencës, trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë dhe krijim të barrierave të panevojshme për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.

Nga analiza e kritereve ISO rezultojnë se Autoriteti Kontraktues ka përdorur standarde joekzistuese, emërtime kontradiktore dhe kërkesa të ndryshme për të njëjtat dëshmi brenda të njëjtit aktivitet të prokurimit, duke krijuar paqartësi juridike dhe trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë.

Nga analiza e kritereve për stafin profesional është vërtetuar se kërkesat ndryshojnë në mënyrë arbitrare nga një lot në tjetrin, ndonëse objekti i kontratës mbetet i njëjtë. Diferencat ekstreme në përvojë profesionale, kualifikime akademike, licenca dhe certifikime nuk mbështeten në asnjë analizë objektive teknike dhe përbëjnë shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë.

Po ashtu, kërkesat për certifikime masive të punëtorëve, sigurime shëndetësore paraprake dhe detyrime të tjera financiare para shpalljes së fituesit paraqesin barrë të pajustificuar ekonomike për operatorët ekonomikë dhe krijojnë avantazh të padrejtë për një numër të kufizuar operatorësh me kapacitete më të mëdha financiare.

Paqartësitë dhe kontradiktat lidhur me dëshmimin e pajisjeve dhe makinerive, trajtimi i ndryshëm i marrëveshjeve të qirasë, kërkesat selektive për noterizim si dhe kushtëzimet e

pamundura për regjistrim dhe sigurim të mjeteve në emër të ofertuesit në fazën e ofertimit, cenonjë rëndë sigurinë juridike dhe transparencën e procedurës së prokurimit.

Gjithashtu, nga analiza e Aneksit 7 është vërtetuar se Autoriteti Kontraktues ka vendosur specifikime teknike të hartuara në mënyrë selektive dhe diskriminuese, përfshirë kufizime me pesha maksimale të makinerive, kërkesa për sisteme teknologjike specifike të lidhura me prodhues të caktuar, si dhe kritere të pashpjegueshme që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me nevojat reale të projektit. Këto kërkesa kanë efekt të drejtpërdrejtë kufizues në konkurrencë dhe bien ndesh me ndalimin ligjor të specifikimeve diskriminuese.

Për më tepër, gabimet materiale, aritmetike dhe teknike të identifikuara në Paramasë dhe Parallogari për Lotet 1, 6, 7 dhe 8 dëshmojnë se dokumentacioni i tenderit nuk është hartuar me kujdesin dhe saktësinë e kërkuar nga legjislacioni i prokurimit publik. Mospërputhjet në rekapitulime, llogaritjet e gabuara të totaleve, mungesa e pozicioneve në kalkulim dhe paqartësitë teknike pamundësojnë ofertimin e drejtë dhe të krahasueshëm nga operatorët ekonomikë.

Në tërësinë e saj, Dosja e Tenderit paraqet një kombinim të shkeljeve procedurale, teknike dhe materiale të cilat kanë cenuar drejtpërdrejt parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht parimin e transparencës, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, konkurrencës së lirë dhe përdorimit efikas të fondeve publike, të garantuara me nenet 1 dhe 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Duke marrë parasysh numrin, natyrën dhe seriozitetin e shkeljeve të konstatuara, këto mangësi nuk mund të konsiderohen gabime të izoluara apo lëshime formale, por paraqesin defekte substanciale në hartimin e Dosjes së Tenderit dhe në zhvillimin e procedurës së prokurimit, të cilat e bëjnë procedurën aktuale të cenueshme dhe juridikisht të paqëndrueshme.

Për këto arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, si dhe të urdhërojë korigjimin e Dosjes së Tenderit dhe eliminimin e të gjitha kritereve, specifikimeve dhe kërkesave që janë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në mënyrë që procedura të zhvillohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme.

IV. Duke u bazuar në dëshmitë dhe sqarimet e ofruara më lartë, kërkojmë nga AK që të merr:

VENDIM

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik **JOOS & KRASNIQI**.
2. Anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 11.06.2026 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.
3. Konstatohet se Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për Kontratë përmbajnë kritere kualifikimi, specifikime teknike, kërkesa administrative dhe elemente të Paramasë dhe Parallogarisë të hartuara në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
4. Urdhërohet Autoriteti Kontraktues që të korigjojë Dosjen e Tenderit dhe dokumentacionin e prokurimit, duke eliminuar të gjitha kriteret diskriminuese,

joproporcionale, kontradiktore dhe kufizuese të konkurrencës, si dhe të korrigojë gabimet materiale, aritmetike dhe teknike të evidentuara në Paramasë dhe Paralogari.

5. Urdhërohet Autoriteti Kontraktues që pas korrigjimit të dokumentacionit të prokurimit të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi të barabartë për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës, ku përfshihen kostot për hartimin e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

NJOFTIM PËR KONTRATË

 PUNË FURNIZIM SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

4.636.124.80 € Vlera Totale e 9 loteve LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol Vlera 541.667.60 Euro nga Kodi 55807 LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zallgjerëm – Lubeniq Vlera 193.280.00 Euro nga Kodi 55878 LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë Vlera 492.991.00 Euro nga Kodi 55990 LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë Vlera 690.185.50 Euro nga Kodi 55991 LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I Vlera 606.257.00 Euro nga Kodi 56142 LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa II Vlera 587.525.00 Euro nga Kodi 56142 LOT 7 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa III Vlera 258.740.00 Euro nga Kodi 56142 LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë pjesa II Vlera 797.368.70 Euro nga Kodi 54660 LOT 9 Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës(Shtupeq i madh dhe Shtupeq i vogel) Vlera 468.110.00 Euro nga Kodi 20722

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E PEJËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës**

Nr i Prokurimit	635-26-3347-5-1-1
Nr i brendshëm	635-26-033-511

Sa i përket tenderit për: Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës

- LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol
- LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq
- LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë
- LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë
- LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I
- LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa II
- LOT 7 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa III
- LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnove – Gjorë pjesa II
- LOT 9 Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës(Shtupeq i madh dhe Shtupeq i vogel)

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.
NUI	810962309
Adresa	JUNIK, 51050, JUNIK, Kosovë
Vendi	JUNIK, Kosovë
Kodi postar	51050
Numri Telefonit	+383 49766804
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Agron Krasniqi
Adresa elektronike	info@jooskrasniqi.com
Data e parashtrimit të kërkesës	11.06.2026



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontratë- 22.05.2026 Afati i parapar per dorezim te tenderit – 22.06.2026 Kerkesa per rishqyrtim – 11.06.2026
--

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Tenderi eshte ne fazën e para dorëzimit te tenderit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 - Qëllimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 - Kriteret e Dhënies së Kontratës

Neni 28 –Specifikimet teknike

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK:

Neni 19 – Specifikimet Teknike

Neni 19.4 – Ndalimi i Kufizimit të Konkurrencës përmes Specifikimeve Teknike

Neni 25.1 – Hartimi i Specifikimeve Teknike

Neni 25.4 – Ndalimi i Referencave Specifike

Neni 26.6 – Standardet e Sigurimit të Cilësisë

Neni 27.1 – Kualifikimet Arsimore dhe Profesionale

Neni 27.4 – Dëshmitë mbi Pajisjet dhe Makineritë

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

I. Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim

Operatori Ekonomik "JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.", si palë e interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, Duke u bazuar në nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, pas analizimit të hollësishëm të Dosjes së Tenderit (DT) dhe Njoftimit për Kontratë, ka identifikuar një sërë shkeljeve esenciale të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Përmes kësaj kërkesë për rishqyrtim, shpërfaqim kriteret joproporcionale, diskriminuese dhe kontradiktore të vendosura nga AK, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë cenojnë

konkurrencën e lirë, trajtimin e barabartë dhe krijojnë barriera të jashtëligjshme artificiale për pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomikë në këtë garë.

Kjo kërkesë parashtrohet brenda afatit ligjor, dhe ka për qëllim shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimeve të Autoritetit Kontraktues, për të cilat vlerësojmë se janë në kundërshtim të hapur me Ligjin për Prokurimin Publik, me Dosjen e Tenderit dhe me rregulloren përkatëse në fuqi.

BAZA LIGJORE E SHKELUR

Kriteret e kontestuara dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si në vijim:

I. DISPOZITAT E LIGJIT NR. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 1 – Qëllimi

Ky nen obligon Autoritetet Kontraktuese që të sigurojnë përdorimin sa më efikas, ekonomik, transparent dhe të drejtë të fondeve publike përmes garantimit të konkurrencës së lirë dhe efektive. Vendosja e kriterëve joproportionale, diskriminuese dhe kufizuese bie ndesh me këtë qëllim, pasi redukton numrin e operatorëve ekonomikë potencialisht të kualifikuar dhe cenon konkurrencën reale në treg.

Neni 7 – Barazia në Trajtim dhe Mosdiskriminimi

Sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues obligohet të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Vendosja e kërkesave të ndryshme për lote me natyrë të njëjtë të punimeve, kërkesa selektive për standarde ISO, profile të veçanta profesionale dhe kriteret të ndryshme teknike pa arsyetim objektiv krijon trajtim të pabarabartë dhe kufizim të konkurrencës.

Neni 27 – Dosja e Tenderit

Ky nen kërkon që Dosja e Tenderit të hartohet në mënyrë të qartë, objektive dhe pa krijuar pengesa të panevojshme për konkurrencën. Kriteret dhe specifikimet e përfshira në dosjen e tenderit nuk duhet të favorizojnë apo diskriminojnë operatorë ekonomikë të caktuar.

Neni 28 – Specifikimet Teknike

Sipas këtij neni, specifikimet teknike duhet të sigurojnë konkurrencë efektive dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Referencat ndaj teknologjive specifike, kufizimet teknike të paarsyetuara dhe kërkesat që favorizojnë pajisje apo sisteme të caktuara bien ndesh me këtë dispozitë.

Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës

Ky nen kërkon që kriteret dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti Kontraktues të jenë të qarta, objektive, të matshme dhe të verifikueshme. Kërkesat kontradiktore lidhur me

makineritë e marra me qira dhe mënyrën e dëshmimit të tyre krijojnë pasiguri juridike dhe mundësojnë vlerësim subjektiv të ofertave.

Neni 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Ky nen kufizon Autoritetin Kontraktues që të kërkojë vetëm ato dëshmi dhe kritere që janë të domosdoshme për të vlerësuar aftësinë e operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratës. Kërkesat që krijojnë barrë të panevojshme administrative ose financiare bien ndesh me këtë dispozitë.

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe Profesionale

Kërkesat për personelin profesional, përvojën, licencat dhe kapacitetet teknike duhet të jenë proporcionale me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës. Kërkesat e ndryshme dhe të paarsyetuara ndërmjet loteve, si dhe imponimi i licencave të kategorisë më të lartë për projekte të rrugëve lokale, tejkalojnë kufijtë e proporcionalitetit të përcaktuar me këtë nen.

II. DISPOZITAT E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 19 – Specifikimet Teknike

Ky nen kërkon që specifikimet teknike të hartohen në mënyrë që të sigurojnë konkurrencë efektive, trajtim të barabartë dhe qasje të papenguar të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. Specifikimet nuk duhet të krijojnë pengesa të panevojshme apo të favorizojnë teknologji, produkte ose operatorë të caktuar ekonomikë.

Neni 19.4 – Ndalimi i Kufizimit të Konkurrencës përmes Specifikimeve Teknike

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë efekt kufizimit artificial të tregut apo favorizimit e operatorëve ekonomikë, produkteve ose teknologjive të caktuara. Kërkesat lidhur me sistemet Variocontrol, GPS, Laser, kufizimet e peshës së makinerive dhe specifikimet e tjera teknike të paarsyetuara cenojnë drejtpërdrejt këtë dispozitë.

Neni 25.1 – Hartimi i Specifikimeve Teknike

Autoriteti Kontraktues obligohet që specifikimet teknike t'i hartojë në mënyrë objektive dhe proporcionale, pa krijuar pengesa të pajustificueshme për konkurrencën. Kërkesat e vendosura në Aneksin 7 nuk përmbushin këtë standard ligjor.

Neni 25.4 – Ndalimi i Referencave Specifike

Kjo dispozitë ndalon referimin në marka tregtare, patenta, teknologji ose produkte specifike, përveç rasteve kur përdoret shprehja “ose ekuivalente”. Referencat ndaj sistemit Variocontrol dhe teknologjive të tjera specifike pa përdorimin e këtij formulimi bien ndesh me këtë nen.

Neni 26.6 – Standardet e Sigurimit të Cilësisë

Kur kërkohen certifikata ISO, ato duhet të jenë të lidhura me objektin e kontratës, të njohura ndërkombëtarisht dhe të kërkuara në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Kërkesat e ndryshme për standardet ISO, si dhe referimet ndaj standardeve të pasakta ose jo valide, bien ndesh me këtë dispozitë.

Neni 27.1 – Kualifikimet Arsimore dhe Profesionale

Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit të kërkuar duhet të jenë drejtpërdrejt të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën e saj. Kërkesa për profile profesionale që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me asfaltimin dhe ndërtimin e rrugëve lokale, si dhe kërkesat e tepruara për licenca dhe përvojë profesionale, bien ndesh me këtë dispozitë.

Neni 27.4 – Dëshmitë mbi Pajisjet dhe Makineritë

Kjo dispozitë lejon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e pajisjeve përmes pronësisë, marrëveshjeve të qirasë ose marrëveshjeve të tjera ligjore. Kërkesat që makineritë e marra me qira të jenë të regjistruara në emër të operatorit ekonomik ofertues ose kërkesat e paqarta lidhur me dokumentacionin e tyre tejkalojnë kërkesat e parapara me këtë dispozitë.

Për rrjedhojë, kriteret e kontestuara në Dosjen e Tenderit janë në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe transparencës, të garantuara nga Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Pretendimi 1: Diskriminim dhe joproporcionalitet i kriterëve ISO (Neni 7 i LPP)

Nga analizimi i kriterëve të vendosura në kapitullin e *Përshtatshmërisë Profesionale* lidhur me certifikimet e cilësisë (ISO), evidentohet një qasje tërësisht joprofesionale dhe diskriminuese nga ana e Autoritetit Kontraktues. Për punë me natyrë krejtësisht të njëjtë (asfaltim rrugësh), AK ka hartuar kërkesat e standardeve ISO me mospërputhje të theksuara teknike, gabime në vite të versioneve të standardeve, si dhe trajtim të pabarabartë sa i përket formës së dëshmimit të tyre.

Mospërputhjet dhe dallimet e pastra arbitrare midis loteve specifikohen si në vijim:

1. Pasqyra Krahasuese e Anomalive të Standardeve ISO sipas Loteve

- **Mospërputhja te standardi ISO 45001 (Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë):**
 - **LOT 1:** AK kërkon versionin **ISO 45001:2015**.
 - **LOT 2 dhe LOT 5:** AK kërkon versionin **ISO 45001:2018**.
 - *Absurdi Juridik/Teknik:* Standardi ndërkombëtar ISO 45001 për herë të parë është publikuar në vitin **2018** (duke zëvendësuar standardin e vjetër OHSAS 18001). Versioni "ISO 45001:2015" nuk ekziston fare në fushën e standardizimit ndërkombëtar. Kjo dëshmon se AK ka shpikur standarde joekzistente për LOT 1, duke krijuar paqartësi totale dhe mundësi eliminimi arbitrar.
- **Luhatja dhe kontradikta te emërtimi i ISO 39001:2012 (Menaxhimi i Sigurisë së Trafikut Rrugor):**
 - **LOT 1:** Ky standard kërkohet me emërtimin: "*...per permirsimin ne siguris në punë*".

- **LOT 2 dhe LOT 5:** Po i njëjti standard kërkohet me emërtimin e saktë: *"...Sistemi I Menagjimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor"*.
- *Absurdi Juridik/Teknik:* Përveç që përbën gabim të rëndë profesional, ky emërtim i ndryshëm për të njëjtin standard brenda të njëjtit tender krijon konfuzion dhe paqartësi juridike në dëm të OE-ve, në kundërshtim me Nenin 60 të LPP-së.
- **Trajtimi i pabarabartë dhe diskriminues në formën e dëshimit (Kopje vs. Noterizim):**
 - **LOT 1:** Mjafton dorëzimi i certifikatave ISO në formë të **kopjes së thjeshtë** (*Dëshmia 3: "Certifikatat ISO per te njejten natyre si projekti (kopje)"*).
 - **LOT 2 dhe LOT 5:** Kushtëzohet në mënyrë rigoroze që certifikatat ISO të jenë të **noterizuara** (*Dëshmia 3: "...me CERTIFIKATË ISO valide- të noterizuara"*).
 - *Absurdi Juridik/Teknik:* Ky është një diskriminim i hapur dhe flagrant. Pse për të njëjtin aktivitet prokurimi dhe për të njëjtat certifikata, një OE që aplikon në LOT 1 lejohet t'i dorëzojë ato si kopje e thjeshtë, ndërsa një OE që aplikon në LOT 2 apo LOT 5 eliminohet nëse nuk i ka të noterizuara? Ky dallim nuk ka asnjë bazë ligjore dhe shkel direkt Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim).

Duke kërkuar një standard që nuk ekziston në tregun ndërkombëtar (ISO 45001:2015 për Lotin 1), Autoriteti Kontraktues ka hartuar një dosje konfuz. Operatorët Ekonomikë e kanë të pamundur të ofrojnë një dokument që nuk ekziston, gjë që çon automatikisht në eliminim të paligjshëm apo në vlerësim subjektiv nga komisioni.

Imponimi i detyrimit për noterizim të certifikatave vetëm për disa lote të caktuara (Lot 2 dhe Lot 5) dhe lejimi i kopjeve të thjeshta për lotet e tjera, paraqet aplikim të dyfishtë të standardeve të vlerësimit për të njëjtën kategori dokumentesh.

Kopjimi i gabuar i termave dhe versioneve të ISO-ve tregon se këto kritere janë vendosur mekanikisht, pa asnjë analizë të mirëfilltë ligjore e teknike, me qëllim të vetëm krijimin e barrierave artificiale.

Emërtimet kontradiktore të të njëjtit standard dhe kushtëzimi selektiv me certifikata të noterizuara vetëm për lote të caktuara, e bëjnë këtë procedurë të prokurimit plotësisht të cenueshme. Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë harmonizimin e menjëhershëm të këtyre kërkesave, të fshijë versionet joekzistente të standardeve dhe të mundësojë që dëshmitë (kopjet) të jenë unike dhe të barabarta për të gjitha lotet, pa ngarkesa të paligjshme financiare e administrative për noterizime selektive.

Pretendimi 2: Kritere të paarsyeshme dhe kufizuese për stafin profesional

Nga analizimi i hollësishëm i kritereve të vendosura për stafin profesional në të 9 lotet e këtij aktiviteti të prokurimit, evidentohet një pabarazi e paprecedentë dhe trajtim tërësisht arbitrar i Operatorëve Ekonomikë. Autoriteti Kontraktues (AK) ka hartuar kërkesa dhe dëshmi në kundërshtim të rrept me LPP, pa asnjë logjikë inxhinierike apo arsyetim objektiv teknik, duke shkelur rëndë parimin e proporcionalitetit dhe të konkurrencës së lirë.

Për të dëshmuar këtë mospërputhje skandaloze, më poshtë paraqesim pasqyrën krahasuese të kritereve të kërkuara sipas loteve për të njëjtën natyrë pune (asfaltim dhe ndërtim rrugësh lokale):

1. Pasqyra Krahasuese e Kushteve të Stafit midis Loteve

- **Menaxheri i Projektit (Inxhinieri i Ndërtimtarisë):**
 - **LOT 1:** Kërkohet Master (Drejtimi Konstruktiv), me **5 vite** përvojë pune dhe i pajisur me **Licencë A**.
 - **LOT 2:** Mjafton Bachelor me **5 vite** OSE Inxhinier i Diplomuar (4-vjeçar) me vetëm **3 vite** përvojë pune (nuk kërkohet licencë specifike).
 - **LOT 3:** Kërkohet Inxhinier i Diplomuar ose Master (Konstruktiv) me **6 vite** përvojë pune, por në mënyrë absurde kjo përvojë kërkohet *pas certifikimit* (jo pas diplomimit).
 - **LOT 4:** Kërkohet Master ose Inxhinier i Diplomuar (Infrastrukturë rrugore ose Konstruktiv) me **5 vite** përvojë pune.
 - **LOT 5:** Kërkohet Master ose Inxhinier i Diplomuar (Konstruktiv ose Infrastrukturë) me **5 vite** përvojë pune PLUS kushtëzimi që të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë.
 - **LOT 6 & 7:** Kërkohet Inxhinier i Diplomuar ose Master (Konstruktiv) me **5 vite** përvojë pune.
 - **LOT 8:** Mjafton niveli Bachelor me vetëm **3 vite** përvojë pune.
 - **LOT 9:** Kërkohet Master ose Inxhinier i Diplomuar (Konstruktiv) me madje **8 vite** përvojë pune, i pajisur me **Licencë të Kategorisë "A"** (sipas Ligjit nr. 08/L-012) dhe i certifikuar si menaxher punishteje për shëndet dhe siguri.
- **Gjeodeti (Inxhinieri i Gjeodezisë):**
 - **LOT 1:** Kërkohet thjesht "Gjeodet i licencuar" me **5 vite** përvojë pune.
 - **LOT 2:** Kërkohet gradë Master me **3 vite** përvojë pune.
 - **LOT 3:** Kërkohet ekskluzivisht gradë Master me **5 vite** përvojë pune.
 - **LOT 5:** Kërkohet Inxhinier i Diplomuar ose Master me një kriter të stërmadh prej madje **8 vite** përvojë pune pas diplomimit.
 - **LOT 6 & 7:** Mjafton niveli Bachelor me **5 vite** përvojë pune dhe i licencuar.
 - **LOT 8:** Mjafton niveli Bachelor me vetëm **3 vite** përvojë pune (pa asnjë kërkesë për licencë).
 - **LOT 9:** Lejohet Inxhinier i Diplomuar/Master me **3 vite** ose Bachelor me **5 vite** përvojë pune.

Mbi bazën e këtij krahasimi, asimetria e kritereve dëshmon pesë gjetje kyçe të cilat e bëjnë këtë Dosje Tenderi të paligjshme:

- **Gjetja I: Diferencim arbitrar, i pashpjegueshëm dhe i çrregullt i përvojes (Shkelje e Nenit 7 dhe 69 të LPP):** Është juridikisht dhe teknikisht e pamundur të arsyetohet se pse për të njëjtin profil të punëve (asfaltim rrugësh brenda të njëjtës komunë), përvoja e kërkuar për të njëjtën pozitë (Menaxher) lëviz në mënyrë kaotike nga **3 vite** (Lot 2, Lot 8), në **5 vite** (Lot 1, 4, 5, 6, 7), në **6 vite** (Lot 3), e deri në **8 vite** (Lot 9). Ky çrregullim tregon qartë se kriteret nuk janë vendosur mbi bazën e kompleksitetit real të punës, por janë përshtatur artificialisht për t'iu përshtatur "CV-ve" të caktuara, duke eliminuar në mënyrë diskriminuese Operatorët e tjerë Ekonomikë.
- **Gjetja II: Paradoksi i Gradave Akademike (Bachelor vs. Master):** Në LOT 3 dhe LOT 5, për pozicionin e Gjeodetit kërkohet në mënyrë strikte grada Master

(madje në Lot 5 me 8 vite përvojë), ndërsa në lotet e tjera si LOT 6, LOT 7 dhe LOT 8 mjafton niveli Bachelor me 3 apo 5 vite përvojë. Nuk ekziston asnjë specifikë topografike apo gjeodezike që arsyeton pse një gjeodet me Bachelor mund të kryejë punët në Lotin 6, ndërsa po në të njëjtin qytet për Lotin 5 na kërkohet titulli Master me 8 vite përvojë. Kjo kërkesë kapërcen parimin e proporcionalitetit të sanksionuar në Nenin 69 të LPP-së.

- **Gjetja III: Monopolizimi i aktivitetit përmes Licencave të Kategorisë "A" (Ligji Nr. 08/L-012):** Në LOT 9, AK ka vendosur një barrierë eliminuese të pakalueshme duke kërkuar që **tre profili të ndryshëm të stafit** (Menaxheri i Projektit, Inxhinieri i Punishtes dhe Inxhinieri i Komunikacionit) të posedojnë që të gjithë **Licencën e Kategorisë "A"** konform Ligjit nr. 08/L-012. Licenca e Kategorisë "A" përfaqëson nivelin më të lartë të licencimit në Republikën e Kosovës (për projekte të Kategorisë së Parë të rrezikshmërisë, si autostrada apo ura të mëdha). Imponimi i njëkohshëm i tri licencave të tilla për rrugë të rëndomta lokale është një mjet i pastër që cenon Nenin 7 të LPP-së, duke dizajnuar garën vetëm për një numër jashtëzakonisht të kufizuar kompanish të mëdha.
- **Gjetja IV: Përfshirja e profileve jashtë objektit të kontratës (LOT 8):** Për LOT 8 (Kërkesa 2.4), AK ka kërkuar pozicionin "*Master i Shkencave në Xehetari, i specializuar për shpim-plasje*". Kërkesa për një inxhinier minierash (xehetarie) në një tender që ka për objekt ekskluziv asfaltimin e rrugëve, është krejtësisht e palogjikshme dhe në kundërshtim të hapur me Nenin 27.1 të Rregullores, i cili kërkon lidhshmëri të drejtpërdrejtë të kualifikimit me objektin e kontratës.
- **Gjetja V: Kërkesa absurde dhe pengesa administrative në dëshmi (LOT 5):** Tek dëshmitë për LOT 5 (Dëshmia 2, 2.1 dhe 2.2), AK kërkon që kontratat e punës të jenë "*kopje e noterizuar në prezencë të punëdhënësit dhe punëmarrësit*". Kjo kërkesë bie ndesh me praktikën e prokurimit dhe me Nenin 27.5 të Rregullores. LPP lejon dorëzimin e parakontratave apo marrëveshjeve të nënshkruara mes palëve si dëshmi angazhimi për projektin. Detyrimi që inxhinierët të shkojnë fizikisht te noteri së bashku me përfaqësuesin e OE-së vetëm për fazën e ofertimit përbën një barrë të paligjshme administrative, e cila çuditërisht nuk kërkohet në asnjë lot tjetër të këtij tenderi.

Ky diferencim ekstrem dhe i paarsyeshëm i kriterëve për stafin teknik nëpër lote të ndryshme për punë me natyrë tërësisht të njëjtë vërteton se Dosja e Tenderit është hartuar në mënyrë selektive, preferenciale dhe me qëllim të kufizimit të qasjes në treg. Rrjedhimisht, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të anulohet këto kritere eliminuese dhe t'i harmonizojë ato në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë sipas LPP-së.

Pretendimi 3: Kërkesa të tepërta për certifikimin e punëtorëve

Për LOT 5, AK kërkon që nga minimumi 20 punëtorë, të paktën 15 prej tyre të jenë të certifikuar për siguri në punë dhe të kenë sigurim shëndetësor përpara datës së publikimit të kontratës. Po ashtu, për LOT 3 kërkohen 10 punëtorë të trajnuar dhe për LOT 9 kërkohen 20 punëtorë të trajnuar nga kompani të licencuara nga MPMS. Trajnimi i stafit mbështetës/punëtorëve fizikë në këtë nivel masiv përpara nënshkrimit të kontratës është një barrë financiare e paligjshme për OE-të që aplikojnë, pasi këto certifikime mund të kërkohen si kusht për ekzekutim të kontratës, por jo si kriter kualifikues në fazën e ofertimit.

Pretendimi 4: Kërkesë e paligjshme e sigurimit shëndetësor para kontratës

Në **LOT 5 (Kërkesa 3 dhe Dëshmia 3)**, Autoriteti Kontraktues (AK) ka vendosur një kriter skandaloz dhe të paprecedentë në praktikën e prokurimit publik, duke kërkuar që:

- *“...minimum 15 punëtorë duhet të jenë të certifikuar për siguri në punë dhe të kenë sigurim shëndetësor nga një kompani e sigurimeve para datës së publikimit të kontratës... Të dëshmohet me faturë / policë të sigurimit me numër të kontratës”.*

Ky kriter përbën shkelje flagrante të parimeve të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 për shkak të këtyre argumenteve juridike të pakontestueshme:

AK detyron Operatorët Ekonomikë (OE) që të bëjnë shpenzime të jashtëzakonshme e të parakohshme luksi financiare (blerjen e policave të sigurimit shëndetësor privat për 15 punëtorë) për një projekt që ende nuk e kanë fituar dhe nuk dihet nëse do ta fitojnë. Kjo kërkesë dëmton rëndë likuiditetin e kompanive të mesme dhe favorizon vetëm oligopolet që kanë kapacitete financiare për të bllokuar mjete në polica sigurimi "në rrezik".

Kërkesat e natyrës sociale, të sigurisë në punë apo të sigurimeve të stafit, mund të jenë **ekskluzivisht kushte për zbatimin e kontratës** (pasi OE të shpallet fitues dhe para nënshkrimit/fillimit të punëve) dhe asnjëherë kritere kualifikuese/eliminuese në fazën e dorëzimit të ofertës.

Asimetri dhe trajtim selektive midis loteve: Ky kushtëzim vlen vetëm për **LOT 5**. Në lotet e tjera me natyrë identike të punës (si **LOT 3, LOT 4, LOT 6, LOT 7, LOT 9**), ku po ashtu kërkohet numër i madh punëtorësh (10 deri në 20 punëtorë), AK-ja *nuk ka kërkuar* polica të sigurimit shëndetësor para tenderimit e as faturë dëshmuese. Pse rrezikshmëria e punës në LOT 5 qenka më e lartë se në lotet e tjera kur objekti i kontratës është i njëjtë (asfaltim)? Kjo vërteton se kriteri është vendosur me tendencë të pastër eliminimi.

Pretendimi 5: Kontradiktë dhe paqartësi në dëshmitë e mjeteve/makinierisë

Tek **Kërkesa 8 dhe Dëshmia 8** (e aplikueshme për të gjitha lotet nga 1 deri në 9), Autoriteti Kontraktues ka hartuar një tekst tërësisht kontradiktor, i cili privon Dosjen e Tenderit nga çdo objektivitet dhe hap rrugë për eliminime masive e te paligjshme.

Në të njëjtin paragraf, AK specifikon:

1. *Nga njëra anë:* Lejon që pajisjet dhe makineria të mos jenë në pronësi të OE, por të kontraktuara apo me qira (*“...që OE duhet t'i ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira)”*).
2. *Nga ana tjetër:* Kushtëzon në mënyrë absolute regjistrimin dhe sigurimin në emër të ofertuesit që në fazën e tenderimit, duke sanksionuar me eliminim: *“Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid... O.E të cilët nuk i kanë pajisjet e regjistruara eliminohen nga ky A.P”*.

Ky formulim krijon një absurditet të pastër juridik dhe teknik:

- **Pamundësia juridike e zbatimit të kriterit:** Nëse një Operator Ekonomik legjitimohet nga LPP-ja dhe nga vetë Dosja e Tenderit që pajisjet (p.sh. ekskavatorë, rula, kamionë) t'i marrë **me qira** apo përmes **marrëveshjes së qirasë/furnizimit**

vetëm nëse shpallet fitues i kontratës, është juridikisht dhe logjikisht e pamundur që ai OE të posedojë librezë regjistrimi apo polica të sigurimit valid të automjeteve në emër të tij në momentin e dorëzimit të ofertës. Regjistrimi dhe sigurimi i takojnë pronarit (qiradhënësit), jo qiramarrësit në fazën e ofertimit!

- **Aplikimi i standardit të dyfishtë për Noterizimin (LOT 2, 8, 9 vs. Lotet e tjera):** Për më tepër, te **Dëshmia 7 dhe 8 (për LOT 2, LOT 8 dhe LOT 9)**, AK kërkon në mënyrë të prerë që: "*Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit*". Ndërsa për të gjitha lotet e tjera, kjo marrëveshje qiraje pranohet si marrëveshje e thjeshtë dypalëshe. Nuk ka asnjë bazë ligjore në LPP që i jep të drejtë AK-së të kërkojë noterizim në prezencë të noterit për marrëveshjet e makinerisë vetëm për tri lote, duke e lënë të lirë për lotet e tjera.
- Ky formulim konfuz, ku lejimi i qirasë përplasat me detyrimin e regjistrimit dhe ku kushtet e noterizimit fluktojnë sipas loteve, cenon parimin e specifikimeve të qarta dhe objektive. Ky draftim joprofesional i DT-së i jep Komisionit të Vlerësimit autoritet diskrecional që të eliminojë cilindo OE që dëshiron me pretekstin e "mungesës së regjistrimit të pajisjeve me qira", duke shkelur hapur parimin e transparencës dhe sigurisë juridike.

PRETENDIMI 6: DISKRIMINIM TEKNIK, ASIMETRI RADIKALE NË SPECIFIKIME DHE CILLËSIM I MAKINERISË TEK ANKES 7

Gjatë analizimit të **Aneksit 7 (Lista e Pajisjeve)** për të gjitha lotet, vrehet një mungesë totale e objektivitetit dhe standardizimit nga ana e Autoritetit Kontraktues. Për projekte të natyrës së njëjtë (asfaltim dhe infrastrukturë rrugore), AK ka aplikuar kriteret e dyfishta, duke vendosur në disa lote specifika jashtëzakonisht kufizuese (kapacitete absurde dhe sisteme specifike teknologjike), ndërsa në lotet e tjera ka lënë kërkesa standarde.

Kjo asimetri vërteton se specifikimet nuk janë përshtatur për nevojat e projektit, por janë dizajnuar si "**kriter porosi**" për të përshtatur makineritë e një Operatori Ekonomik të caktuar dhe për të eliminuar të tjerët.

1. Absurditeti dhe Kufizimi me "Pesha Maksimale" (Kriter Eliminues pa Logjikë Inxhinierike)

Në praktikën e prokurimit dhe inxhinierisë, kapaciteti teknik i një makinerie kërkohet gjithmonë si "**minimum**" (p.sh. min. 15 ton) për të siguruar që pajisja ka fuqi të mjaftueshme për të kryer punën. AK, në mënyrë të paprecedentë, në disa lote ka vendosur "**peshë maksimale**" (**max**), gjë që do të thotë se nëse një OE ka makineri më të re, më të fuqishme dhe me kapacitet më të lartë, ai **eliminohet!**

- **Te LOT 5 (Pika 3 & 10):** Kërkohej *Dumper me peshë max 3 ton dhe Grejder me peshë max 9 ton.*
- **Te LOT 7 (Pika 1 & 3 & 4):** Kërkohej *Eskavator skip max 8.2 ton, Mini Autobetoniere max 7 ton, dhe Valak max 1.4 ton.*
- **Te LOT 9 (Pika 5 & 19):** Kërkohej *Cilindër max 2.5 ton dhe Cilindër për kanal max 1.5 ton.*

Ky kufizim me "kapacitet maksimal" shkel ne menyre flagrante **LPP-në**, i cili ndalon specifikimet që krijojnë pengesa për konkurrencën e hapur. Nuk ka asnjë arsye teknike apo

inxhinierike pse një grejder 12 tonësh nuk mund ta bëjë punën e një grejderi "max 9 ton". Ky është një specifikim i pastër përjashtues.

2. Kushtëzimi me Pajisje Specifike dhe "Sisteme Ekskluzive" (Variocontrol, Laser, GPS, Kamera 360°)

AK ka specifikuar brendësi dhe teknologji të veçanta që gjenden vetëm te marka të caktuara të makinerive, duke shkelur **LPP-në** (i cili ndalon referencat në marka, patentë apo lloje të veçanta nëse nuk shoqërohen me "ose ekuivalente"):

- **Te LOT 5 (Pika 9):** Kërkohe *Cilindër min 17t vibrues ta ketë të instaluar edhe sistemin e matjes së ngjeshshmërisë (variocontrol)*. Sistemi "Variocontrol" është patentë e mbrojtur teknologjike e prodhuesit të njohur **BOMAG**. Ky emërtim i pastër teknik përjashton çdo cilindër tjetër (Caterpillar, Hamm, Dynapac) që përdor emërtime të tjera për sistemet e matjes.
- **Te LOT 4 (Pikat 2, 4, 5, 6, 7):** Kërkohe *Buldozer me kontroll gjeodezik GPS, Eskavator me sistem kontrolli të lugës 360 shkallë dhe krah llaserik, Makinë gërryese me sistem kontrolli llaserik dhe kamera përcjellëse, Makinë finisher me GPS dhe laser.*
- **Pse ky standard nuk vlen për lotet e tjera?** Në **LOT 2, LOT 3, LOT 6, dhe LOT 9** kërkohen po ashtu makina gërryese (freza), finisherë dhe eskavatorë për të njëjtat punë asfaltimi, por aty **NUK** kërkohen sisteme GPS, krahë llaserikë apo kamera 360 shkallë. Ky diferencim arbitrar dëshmon se te LOT 4 kriteret janë ngritur qëllimisht për të eliminuar konkurrencën.

3. Mosstandardizimi i absurd i kapaciteteve për të njëjtën makineri midis loteve

Dallimet në tonazhe për të njëjtën punë rrugore tregojnë se AK nuk ka pasur asnjë kriter objektiv gjatë hartimit të dosjes:

- **Eskavatorët:** Te **LOT 1**, kërkohet *Eskavator me zingjir min. 62 ton* (një megamakineri minierash, tërësisht e pajustificueshme për punë rrugore standarde). Te **LOT 6** kërkohet *min. 39 ton*, te **LOT 4** mbi *37 ton*, te **LOT 9** *min. 35 ton*, ndërsa te **LOT 2** mjafton *min. 20 ton*.
- **Kamionët e Asfaltit (Kiperët):** Te **LOT 2 (Pika 21)** kërkohen *5 Kamionë kiper me peshë min. 32t*. Ndërsa te **LOT 5 (Pika 18)**, ku po ashtu shtrohet asfalt, kërkohen *8 Kamionë kiper me peshë min. 15t*. Pse asfalti i LOT 2 nuk u transportuaka me kamionë 15 tonësh?

4. Kërkesa absurde për dëshmi të performancës në listë pajisjesh

Në fund të Aneksit 7, për të gjitha lotet thuhet: "*Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe t'i bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë*".

Çfarë nënkupton AK me "dokument që evidenton performimin e tillë" për një makineri me qira? Sipas LPP-së, pajisjet dëshmohen vetëm me dëshmi pronësie (libreza/fatura) ose marrëveshje qiraje. Kërkesa për "certifikata performimi" të makinerive krijon paqartësi totale dhe i jep komisionit hapësirë për vlerësim subjektiv dhe te anshem (shkelje e **Nenit 52 të LPP-së**).

PRETENDIMI ANKIMOR 7: Shkelje thelbësore të Ligjit për Prokurimin Publik përmes hartimit të paramasave të pasakta, me gabime materiale, aritmetike dhe pozicione të paanalizuara mirë;

Gjatë shqyrtimit analitik dhe teknik të Dosjes së Tenderit (DT) për këtë aktivitet të prokurimit, është konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka hartuar një paramasë dhe paraqitje të pozicioneve me gabime të rënda materiale, kalkulime të pasakta aritmetike dhe mungesë të llogaritjes së totaleve. Këto parregullsi, të cilat prekin disa lote, manifestohen në mënyrë specifike si në vijim:

- **Pika 1. Gabimet dhe mospërputhjet në rekapitulim për LOT 1 (“Poqestë – Doberdol”):** Në kuadër të këtij loti është evidentuar një shpërputhje e rëndë në kalkulimin e vlerave totale të punëve, posaçërisht në pjesën e rekapitulimit:
 - *Rekapitulimi te Punët Tokësore:* Ka gabime të qarta në bartjen dhe llogaritjen e vlerave të përgjithshme për këtë kategori.
 - *Aneksi 1 dhe 2 të Punëve Tokësore:* Këto anekse paraqesin shpërputhje të hapura matematiko-teknike me pjesën tjetër të paramasës.
 - *Rekapitulimi Total:* Është identifikuar gabim direkt dhe i pastër në llogaritjen e vlerës për pozicionin “*Ndërtimi i murit mbrojtës*”.
- **Pika 2. Gabimet në llogaritjen e totaleve specifike për LOT 6 (“Rikonstruksioni i rrugëve të qytetit”):** Në Pozicionin 4, që ka të bëjë me “*Punët e betonit dhe asfalt*”, është evidentuar një gabim material që ndikon direkt në vlerën finale të ofertës. Gabimi qëndron në mosllogaritjen apo kalkulimin plotësisht të gabuar të totalit për nën-pozicionet 4.1 dhe 4.2.
- **Pika 3. Gabimet teknike dhe procedurale për LOT 7 (“Ndërtimi dhe rregullimi i trotuarit nga rrethi i Soliterit deri te rrethi i Stacionit”):** Konkretisht në **Pozicionin 6.1. "Testimet e ngjeshmërisë"**, është identifikuar një parregullsi e qartë teknike dhe procedurale, e cila ndikon drejtpërdrejt në strukturën e çmimit dhe në pamundësinë e ofertimit të barabartë.
- **Pika 4. Eliminimi i nën-pozicionit nga kalkulimi total për LOT 8 (“Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Seinovë”):** Në Pozicionin 3 (“*Konstruksioni i hapësirës*”), është lëshuar një gabim thelbësor matematikor ku nën-pozicioni **Pos. 3.7. NUK është llogaritur fare** në vlerën totale të këtij loti, duke e lënë paramasën të mangët.

Të gjitha paqartësitë, eliminimet e pozicioneve (si në LOT 8), gabimet në totale (si në LOT 6) dhe mospërputhjet në rekapitulime (si në LOT 1) bien në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet bazë të prokurimit publik në Kosovë.

VI. PËRFUNDIMI DHE KËRKESA

Nga analiza e plotë e Dosjes së Tenderit, kritereve kualifikuese, specifikimeve teknike dhe dëshmime të kërkuara për secilin lot të këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se Autoriteti Kontraktues ka vendosur një sërë kërkesash të cilat nuk janë në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës efektive, të garantuara me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Në veçanti, Dosja e Tenderit përmban kërkesa të ndryshme dhe të paunifikuara për lote që kanë objekt të njëjtë ose shumë të ngjashëm të kontratës, pa ndonjë arsyetim teknik apo profesional të dokumentuar. Kjo qasje ka rezultuar në vendosjen e kritereve të ndryshme për standardet ISO, personelin profesional, makineritë dhe pajisjet, si dhe në përfshirjen e

kërkesave që për nga natyra e tyre paraqesin kushte të ekzekutimit të kontratës dhe jo kritere të pranueshmërisë apo kualifikimit.

Po ashtu, nga krahasimi i kritereve ndërmjet loteve evidentohet mungesa e një qasjeje të standardizuar dhe proporcionale, gjë që krijon paqartësi juridike, kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë potencialisht të kualifikuar dhe cenon objektivin themelor të prokurimit publik për sigurimin e konkurrencës sa më të gjerë dhe përdorimin efikas të fondeve publike.

Për më tepër, një numër i konsiderueshëm kërkesash të vendosura në dosjen e tenderit nuk dëshmohej se kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe proporcionale me objektin e kontratës, ndërsa disa prej tyre krijojnë barrë të panevojshme administrative dhe financiare për operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit.

Për këto arsye, dhe me qëllim të evitimit të zhvillimit të mëtejshëm të procedurës mbi bazën e kritereve të cilat mund të cenojnë ligjshmërinë e saj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për harmonizimin dhe korrigjimin e Dosjes së Tenderit në përputhje me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik.

Prandaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

1. Të aprovojë si të bazuar këtë Kërkesë për Rishqyrtim;
2. Të pezullojë procedurën e prokurimit deri në shqyrtimin dhe korrigjimin e plotë të çështjeve të ngritura në këtë kërkesë;
3. Të korrigjojë dhe harmonizojë Dosjen e Tenderit duke:
 - eliminuar mospërputhjet dhe kërkesat joproportionale lidhur me standardet ISO dhe mënyrën e dëshmimit të tyre;
 - rishikuar kriteret për stafin profesional, duke siguruar që kualifikimet, përvoja profesionale, licencat dhe profilet e kërkuara të jenë në lidhje të drejtpërdrejtë dhe proporcionale me objektin e kontratës;
 - larguar nga faza e kualifikimit të gjitha kërkesat që për nga natyra e tyre përbëjnë kushte të ekzekutimit të kontratës, përfshirë sigurimet dhe trajnimet e personelit;
 - riformuluar kërkesat për pajisjet dhe makineritë në mënyrë të qartë, objektive dhe jo-diskriminuese, duke eliminuar paqartësitë dhe kufizimet që mund të favorizojnë produkte, teknologji apo operatorë të caktuar ekonomikë;
4. Të publikojë amendamentet përkatëse në Dosjen e Tenderit dhe të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, në mënyrë që të garantohet konkurrencë e hapur, trajtim i barabartë dhe pjesëmarrje sa më e gjerë e operatorëve ekonomikë.

Në rast se kërkesa nuk aprovohet, Operatori Ekonomik rezervon të drejtën që, në afatet ligjore, të ushtrojë mjetet juridike pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij ligjore.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim, ku përfshihen kostot për hartimin e kërkesës për rishqyrtim, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*



ZYRA E PROKURIMIT
KOMUNA E PEJËS

Pejë, 11.06.2026

VENDIM MBI KËRKESËN PËR RISHQYRTIM

Në mbështetje të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 dhe, autoriteti kontraktues Komuna e Pejes (ne vazhdim AK KK PEJE . apo Autoriteti Kontraktues) ka shqyrtuar Kërkesën për Rishqyrtim të operatorit ekonomik **JOOS & KRASNIQI – BAZ SH.P.K** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit **Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës**

LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol

LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniç

LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë

LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë

LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaç, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I

LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaç, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa II

LOT 7 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaç, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa III

LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë pjesa II

LOT 9 Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës(Shtupeq i madh dhe Shtupeq i vogel
Me numer te prokurimit te brendeshem: 635-26-033-511 dhe me numer te prokurimit te jashtem
635-26-3347-5-1-1 dhe ne lidhje me kërkesën, nxjerr këtë:

V E N D I M

Me datën 11.06.2026 , Operatoi Ekonomik **JOOS & KRASNIQI – BAZ SH.P.K** ka parashtruar kërkesen për ri-shqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues (KOMUNA E PEJES):

- I. Cilësohet si **e refuzuar** kërkesat për ri-shqyrtim nga operatori ekonomik **JOOS & KRASNIQI – BAZ SH.P.K** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit : **Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës**
LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol
LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniç
LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë
LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë
LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaç, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I
LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaç, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa II
LOT 7 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaç, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa III
LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë pjesa II

II. Mbeten në fuqi të gjitha kriteret, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

A R S Y E T I M

VLERËSIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES MBI PRETENDIMET E OE JOOS & KRASNIQI – BAZ SH.P.K

Pas analizimit të hollësishëm të të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues konstaton se kërkesa në fjalë nuk përmban argumente juridike dhe as prova materiale të cilat do të dëshmonin ekzistimin e ndonjë shkeljeje të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik apo të legjislacionit sekondar në fuqi.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimet e Operatorit Ekonomik bazohen kryesisht në interpretime subjektive dhe në mospajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, e jo në shkelje konkrete të dispozitave ligjore.

Në pajtim me nenin 7 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të sigurojë konkurrencë efektive, trajtim të barabartë dhe përdorim efikas të fondeve publike. Për realizimin e këtij obligimi ligjor, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesa dhe kriteret të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me natyrën, kompleksitetin, rëndësinë dhe vlerën e kontratës.

Autoriteti Kontraktues thekson se kriteret e vendosura nuk janë hartuar për të kufizuar konkurrencën, por për të siguruar që operatori ekonomik i cili do të shpallet fitues të posedojë kapacitetet e nevojshme teknike, profesionale dhe organizative për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara.

Për më tepër, gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit janë marrë parasysh në mënyrë të vazhdueshme rekomandimet, vërejtjet dhe praktiket e monitorimit të KRPP-së, me qëllim të harmonizimit të plotë të dokumentacionit me legjislacionin në fuqi dhe praktikat më të mira të prokurimit publik.

Autoriteti Kontraktues konsideron se çdo kriter i përcaktuar në dosjen e tenderit është i justifikuar objektivisht, proporcional me objektin e kontratës dhe i nevojshëm për garantimin e realizimit të suksesshëm të projektit. Asnjë nga kriteret e kontestuara nuk paraqet kufizim të paarsyeshëm të konkurrencës dhe as nuk krijon avantazh apo disavantazh për ndonjë operator ekonomik të caktuar.

Në asnjë pjesë të kërkesës për rishqyrtim Operatori Ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë se kriteret e vendosura:

- janë në kundërshtim me ndonjë dispozitë të LPP-së;
- janë joproporcionale me objektin e kontratës;
- janë diskriminuese ndaj operatorëve ekonomikë;
- favorizojnë ndonjë operator ekonomik të caktuar;

- cenojnë parimet themelore të prokurimit publik.

Përkundrazi, nga analiza e dokumentacionit rezulton se kriteret janë të arsyeshme, ligjore dhe të domosdoshme për realizimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues konsideron se ndryshimi ose largimi i kriterëve të kontestuara, pa ndonjë bazë ligjore dhe pa ndonjë argument të mbështetur në prova konkrete, do të cenonte interesin publik, do të rrezikonte realizimin cilësor të kontratës dhe do të binte ndesh me parimet e menaxhimit të përgjegjshëm të fondeve publike.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar asnjë bazë faktike apo juridike që do të justifikonte ndërhyrjen në dokumentacionin e tenderit apo ndryshimin e kriterëve të përcaktuara.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat e lartcekura, Autoriteti Kontraktues konstaton se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar në tërësi, nuk dëshmon asnjë shkelje të dispozitave ligjore dhe nuk krijon asnjë rrethanë që do të impononte ndryshimin e dokumentacionit të tenderit.

KONKLuzion

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues vendos që kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga OE **JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K.** të refuzohet si e pabazuar dhe të mbeten në fuqi të gjitha kriteret, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Me respekt

MILOT Gashi
Menaxher i Prokurimit.

